



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 24 të Ligjit Nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor të datës 19.01.2006 , Udhëzimit Administrativ nr. 41/2007 - Zbritja e tarifave që duhet të paguhet nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____2022 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

MBI CAKTIMIN E TARIFAVE PËR QENDRIMIN DITOR TË FËMIJËVE NË QENDRËN PËR EDUKIMIN DHE ARSIMIMIN PARASHKOLLOR NË LIPJAN

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Vendim përcaktohen obligimet e prindërve për pagesën e tarifave, procedura për lirim nga pagesa e këtyre tarifave si dhe zvogëlimet e tarifave për qëndrim ditor të fëmijëve në Qendrën për edukim dhe arsimimin parashkollor në Lipjan.

Neni 2

Kompenzimi për qëndrim ditor

Prindërit, përkatësisht kujdestarët, për vendosjen e fëmijëve për qëndrim ditor në Qendrën për edukim para fillor në Lipjan, në emër të participimit për një fëmijë, për çdo muaj duhet të paguajnë shumën prej **80.00 €**.

Neni 3

Lirimi nga pagesa e tarifave

Lirimi nga pagesat e përcaktuara në nenin 1 të këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat ligjore .

Neni 4

Zvogëlimi i tarifave

Prindërit përkatësisht kujdestaret e fëmijëve do të paguajnë tarifën e zvogëluar për qëndrimin ditor për më shumë se një fëmijë, s'i vijon:

Për fëmijën e dytë shumën prej 50.00 €.

Për fëmijën e tretë shumën prej 30.00 €.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen e Komunës.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi mbi caktimin e tarifave për qëndrimin ditor të fëmijëve në Qendrën për Edukimin dhe arsimimin parashkollor në Lipjan 15 Nr.610-47675 i datës 29.09.2015.

A r s y e t i m i

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim -vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 24 të Ligjit Nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor të datës 19.01.2006 , Udhëzimit Administrativ nr. 41/2007 - Zbritja e tarifave që duhet të paguhet nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Me dispozitat e nenit 24 të Ligjit Nr. 02/L-52 Mbi Edukimin Parashkollor parashihet: "Tarifat që duhet të paguhet nga prindërit do të përcaktohen nga Komuna në bazë të një shkalle që grupon prindërit në të ardhurat për pjesëtarë të familjes në krahasim me pagën mesatare në Kosovë dhe pasurisë familjare"

Duke u bazuar në dispozitën e sipër cituar propozojmë miratimin e këtij Vendimi.

1Nr. 40061-29355
Lipjan, më 07.06. 2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

